



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201600634/2

Tiranë ___/___/2016

Lënda : Rekomandojmë marrjen e masave për shpejtimin e gjykimit të dosjes administrative me Nr.11264 regj. datë 29.01.2016, me paditës I. S. nga Tirana.

Drejtuar : Z.Kastriot SELITA
Kryetar i Gjykatës Administrative të Apelit
TIRANË

I nderuar zoti Kryetar,

Në ankesën e tij datë 31.03.2016, drejtuar institucionit të Avokatit të Popullit, shtetasi I. S. nga Tirana ankohet për zvarritje gjykimi pa shkaqe ligjore dhe shkeljen e procedurave gjyqësore, nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, në gjykimin e një çështje administrative kundra D.R.S.SH. Tiranë, me objekt anulim si të padrejtë të një urdhër mbyllje pensioni pleqërie dhe detyrimin e palës së paditur për pagimin e pensionit të pleqërisë në të ardhmen.

Nga ankesa e tij rezulton se dosja e ankuesit I. S. mban Nr.11264 akti datë 29.01.2016, se ajo është hedhur në short nga Gjykata e Apelit dhe si relatore për gjykim është caktuar Zj.Blerina HASA..

Nga studimi me kujdes i kësaj ankese rezulton gjithashtu se mbyllja e dosjes pensionit të ankuesit I.S. nga D.R.S.SH. Tiranë, është bërë me datë 31.03.2010 dhe deri tani meqenëse kanë vazhduar rrugët gjyqësore në të gjitha shkallët e gjyqësorit ka bërë që pasojat negative t'i vuaj ankuesi duke ju ndërprerë padrejtësisht të gjitha të ardhurat që i takojnë nga pagesa e pensionit të pleqërisë në bazë të legjilacionit në fuqi.

Me vendimin gjyqësor Nr.591 datë 05.11.2015, të Gjykatës së Lartë Tiranë, është vendosur përfundimisht prishja e vendimit Nr.628 datë 13.03.2013 të Gjykatës së Apelit Tiranë, dhe dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë. Në Gjykatën tuaj kjo dosje gjyqësore tani ndodhet e regjistruar për gjykim me Nr.11264 regj. datë 29.01.2016, dhe si relatore në bazë të shortit të hedhur është caktuar Zj.Blerona HASA.

Në rastin konkret ankuesi I. S. na shkruan se gjykatat ndaj tij nuk kanë zhvilluar një proces të rregullt gjyqësor dhe se me zvarritjet e bëra deri tani gjykatat kanë cënuar rëndë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, në lidhje me të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanëshme e caktuar me ligj.

Në nenin 3 të Ligjit nr.49/2012 për Organizimin dhe Funkcionimin e Gjykata Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative, ndër parimet e gjyimit administrativ ka përcaktuar sigurimin e një procesi të rregullt gjyqësor brenda afateve të shpejta dhe të arsyeshme. Ky ka qënë edhe qëllimi i ligjvënësist për krijimin e këtyre gjykatave.

Ligji synon thjeshtimin e procedurave me objekt zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative dhe qëllimi i krijimit të Gjykata Administrative është garantimi i mbrojtjes efektive të të drejtave të subjekteve dhe interesave të ligjshme të personave nëpërmjet një procesi të rregullt gjyqësor brenda afateve të shpejta e të arsyeshme.

Në nenin 48/2 të Ligjit Nr.49/2012 parashikohet gjithashtu se Gjykata Administrative e Apelit shqyrton çështjen brenda 30 ditëve, nga data e ardhjes së ankimit nga gjykata ku është paraqitur. Ky qëndrim është përcaktuar edhe nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese në disa vendime të saj siç janë ato me Nr.69/2015, Vendimi me Nr.81/2015 dhe vendimi me Nr.14/2016.

Ky rast mendojmë se duhet vlerësuar nga ju si një rast i veçantë, që vjen për gjykim nga prishja e vendimit nga Gjykata e Lartë Tiranë, për një person i moshuar rreth 80 vjeç, të cilit i është ndërprerë pensioni i pleqërisë padrejtësisht nga DRSSH Tiranë nga data 31.03.2010.

Në nenit 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, thuhet se: "Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave të njeriut, nga administrata publike", dhe të nenit 21/c të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", ku thuhet se pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrjen e masave për vënien në vend të së drejtës së shkelur, tek organi epror i organit që ka shkaktuar shkeljen".

Për sa më sipër, ju

REKOMANDIJNË :

1. Të shikohen nga ana juaj të gjitha mundësit ligjore të shpejtimit dhe të gjyimit të dosjes gjyqësore me Nr.11264 regj.datë 29.01.2016 me paditës I. S. kundra DRSSH Tiranë, sa më shpejt.

2. Mbi shqyrtimin e këtij rekomandimi dhe masat e marra nga ana juaj, lutemi të njoftohemi me shkrim brenda 30 ditëve.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Arben SHKËMBI